

Në mbështetje të nenit 40.2 nen b dhe c të ligjit për vetqeverisjen lokale Nr 03/L 040, si dhe nenit 34.6 nen c dhe e të Statutit të komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me 17.09.2010 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONË PËR VITIN 2011

Neni 1

Në pajtim me nenin 6.2 të Rregullorës 2003/29, normat tatimore të tatimit në pronën e paluajtëshme për vitin 2011, në komunën e Drenasit janë si vijon:

Përshkrimi	Norma
Pronat rezidenciale - shtëpitë	0.11%
Pronat rezidenciale - banesat	0.11%
Pronat komerciale	0.15%
Pronat industriale	0.30%
Pronat bujqësore	0.05%
Garazhat	0.05%
Pronat e braktisura	0.05%
Pronat e papërfunduara	0.11%
Pishinat dhe fushat sportive	0.15%

Neni 2.

Në bazë të shqyrtimit të kontratave të shitëblerjeve dhe parametrave tjerë kemi nxjerrë vlerën e tregut për të gjitha llojet e objekteve dhe i kemi klasifikuar në katër zona tatimore

	0.11%	0.11%	0.15%	0.30%	0.05%	0.05%	0.05%	0.11%	0.15%
Zona	Prona Rezid. shtëpi	Prona rezide banesa	Pronat komerci ale.	Pronat industri ale.	Prona bujqës ore.	Garazh	Prona e brakti sura.	Pronat e papërfunduara.	Pishinat dhe fushat sportive
I	300,00	350,00	600,00	230,00	100,00	100,00	300,00	120,00	200,00
II	250,00	320,00	450,00	230,00	100,00	100,00	250,00	100,00	150,00
III	200,00	-	350,00	230,00	100,00	100,00	200,00	80,00	150,00
IV	150,00	-	270,00	230,00	100,00	100,00	150,00	60,00	150,00

Neni 3.

Teritori i komunës së Drenasit , ndahet në katër zona tatimore dhe këto janë:

1 . Zona e parë:

Drenas

1.1.Në zonën e parë në Drenas hyjnë , objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Bushat-Skenderaj, dhe fillon nga Ura e lumit Drenica dhe vazhdon deri te njisiti i zjarrfikësve.

1.2.Objektet e banimit dhe objektet tjera që gjenden në të dy anët e rrugës „ Fehmi e Xhevë Lladrovci”.

1.3.Objektet e banimit dhe objektet tjera që gjenden në të dy anët e rrugës së „Feronikelit” dhe fillon nga stacioni i trenit deri te porta kryesore e feronikelit.

1.4.Objektet e banimit dhe objektet tjera , që gjinden në qendren e Drenasit dhe kanë lidhje me rrugën e asfaltuar, dhe ato të cilat në mes të objekteve të pikës1.1 dhe1.2 si dhe objektet që gjenden në mes të rrugës„Fehmi e Xhevë Lladrovci” dhe rrugës që hyn në mes të lagjës së Seferajve dhe Hasve dhe vazhdon deri te kryqëzimi me rrugën e „Feronikelit”.

Bushat (Komoran)

1.5. Hyjnë të gjitha objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Prishtinë – Pejë dhe fillon nga rruga që fillon të hyjë në Bushat nga Prishtina (ish rrugë vjetër), vazhdon kryqit kryesor dhe përfundon te rruga që hyn në lagjën e Bogajve.

1.6. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Prishtinë-Pejë , Bushat – Drenas dhe vazhdon deri te kryqëzimi i rrugës në qendër të Bushatit dhe vazhdon deri te kryqëzimi për Sankoc (Flamuras) dhe për lagjën e urbanizuar. Në këtë zonë hyn edhe objektet që gjenden në të dy anët e rrugës për në Nikaj (Nekoc) deri te rruga që hyn për mulli.

2. Zona e dytë :

2.1. Në zonën e dytë hynë të gjitha objektet e banimit dhe objektet tjera në Drenas që gjenden në lagjët e Drenasit II dhe III si dhe Lagja e Feronikelit dhe e Xhamisë.

2.2. Paklek i Ri, Korrotica e Ultë, Shtrubullova, Çikatova e Re, Çikatova e Vjetër, Zabel i Ulët , Lagja e urbanizuar e Komoranit dhe objektet tjera rreth qendrës që nuk janë përfshirë në zonën e parë.

2.3. Objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Prishtinë-Pejë dhe fillon me hyrjen e rrugës në teritorin e komunës së Drenasit e vazhdon deri te zona e parë e Komoranit . Nga rruga që hyn në lagjën e Bogajve ku dhe ka përfunduar zona e parë sipas kësaj rregulloreje vazhdon deri në përfundim të teritorit të komunës së Drenasit.

2.4. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës ku fillon kryqi i rrugës Arllat-Malishevë deri te përfundimi i rrugës në teritorin e komunës së Drenasit.

2.5. Objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas-Skenderaj dhe fillon prej njësitit të zjarrfikësve dhe përfundon në dalje të teritorit të komunës së Drenasit .

2.6. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e Rrugës Drenas-Krajkovë ku fillon nga hekurudha e trenit dhe vazhdon deri të shkolla fillore e Krajkovës.

2.7. Objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas-Abri ku fillon nga ura e lumit (lagja e Balcëve) dhe përfundon te shkolla fillore e fshatit Baicë .

2.8. Objektet e banimit dhe objektet tjera të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas-Gradicë dhe fillon nga kryqëzimi i rrugës “ Fehmi dhe Xhevë LLadrovci” dhe vazhdon deri te shavarinat ku ndahet rruga për shkollën fillore të Dobroshevcit(Dritanit).

3. Zona e Tretë :

3.1. Në zonën e tretë hynë objektet e banimit dhe objektet e tjera që gjenden në lagjet tjera jashtë qendrës së Bushatit(Komoranit) .

3.2. Kizhareka (Ndrekaj), Nekoci (Nikaj), Zabel i Naltë, Fushticë e Ultë, Krajkovë, Damanek, Korroticë e Epërme, Gllobar (Bletar) dhe Paklek i Vjetër.

4. Zona e Katërt:

4.1. Në këtë zonë hynë objektet e banimit dhe objektet tjera që gjenden në Arllat, Llapushanë, Negrovc (Fatos), Vuqak(Nënkala), Verbovc (Fortesë), Baicë(Rezistencë) Abri, Terstenil, Polluzhë Shtuticë (Kodër), Likoshan, Gradicë(Dodonë), Godanc (Shpat), Gllanasellë (Shkallë), Dobroshevc(Dritan), Vasilevë(Malësi), Sankoc(Flamuras), Fushticë e Epërme dhe Terdevc(Grykas).

Neni 4.

Në pajtim me nenin 10.2 të Rregullorës 2003/ 29mbi përgjegjësitë komunale , Kryetari i Komunës së Drenasit emron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2011 .

Neni 5

Kjo Rregullore aplikohet nga Drejtoria për Financa- Zyra e tatimit në pronë , për caktimin e tatimit në pronë gjatë vitit 2011.

Neni 6

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/29 mbi "Vendosjen e tatimit në pronën e palujtëshme në Kosovë" të datës 5 shtator 2003 dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha qështjet tjera që kanë të bëjnë me tatimin në pronë.

Neni 7

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të aplikohet nga 1 janari 2011.

KRYESUESI I KUVENDIT

Fatmir Islogu

